



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr _____prot

Tiranë më ____ . ____ .2024

**VENDIM
Nr. 654, datë 31.10.2024**

**PËR
HAPJEN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRËN E GJYQTARIT
NË GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, PËR NJË
POZICION TË LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 2 dhe 3, të nenit 8, në shkronjën “a”, të pikës 1 dhe në pikën 4, të nenit 47, në pikën 2, në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 3, në pikat 5, 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 61, në shkronjën “ç”, të nenit 86 dhe në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

I. Hapja e procedurës dhe shpallja e kërkesës për kandidatura

1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.
2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë.

II. Afati i kandidimit

3. Afati i kandidimit është deri më datë 15.11.2024.

III. Informacioni dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet kandidimit

4. Në procedurën e ngritjes në detyrë sipas këtij vendimi mund të konkurrojnë çdo gjyqtar që është në një pozicion në një gjykatë të shkallës së parë ose në një pozicion të komanduar, i cili plotëson kriteret ligjore të ngritjes në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë.

5. Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t'u ngritur në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë përcaktohen në pikën 3, të nenit 8, në pikën 4, të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si më poshtë:
- a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës penale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;
 - b) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar;
 - c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
6. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente :
- a) Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë të shpallur;
 - b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
 - c) Fotokopje të kartës së identitetit;
 - ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
 - d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi.
- 7) Dokumentacioni sipas pikës 6, të këtij vendimi, duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

IV. Procedura e kandidimit

- 8) Pas përfundimit të afatit të kandidimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, kandidatët i nënshtrohen procesit të verifikimit të plotësimin të kriterëve ligjore të kandidimit sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për

procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar.

9) Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional:

a) sipas Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe Vendimit të tij nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, për kandidatin në një pozicion në sistemin gjyqësor;

ose

b) sipas Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” dhe Vendimit të tij nr. 209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”, për kandidatin në një pozicion të komanduar, i cili nuk ka vlerësim etik dhe profesional nga institucioni i sistemit të drejtësisë ku është i komanduar.

10) Për kandidatët e kualifikuar me vendim përfundimtar sipas Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, pas përfundimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional, zbatohet procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë sipas Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARI

ILIR RUSI

Spektori i Organizimit të Mbledhjeve: Krisulla Kasaj
Departamenti i Shërbimeve Juridike: Blerta Ngucaj
Sekretar i Pergjithshem: Rudin Baqli
Komisioni i Zhvillimit të Karrierës: Klodian Kurushi

VETËDEKLARIM
PËR MASA DISIPLINORE

Unë gjyqtari/ja _____(*emër, atësia, mbiemri*), në cilësinë e kandidatit në procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 654, datë 31.10.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me kriterin e përcaktuar në pikën 6, të nenit 43, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

DEKLAROJ SE:

Nuk kam masë disiplinore në fuqi.

Lëshuar më ____ . ____ . ____

DEKLARUESI

(Emri, atësia, mbiemri)
(Nënshkrimi)

VETËDEKLARIM

PËR SITUATËN E PAPAJTUESHMËRISË AMBIENTALE

Unë gjyqtari/ja _____ (*emër, atësia, mbiemri*), në cilësinë e kandidatit në procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 654, datë 31.10.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me kriterin e përcaktuar në pikën 6, të nenit 43, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

DEKLAROJ SE:

Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Lëshuar më ____ . ____ . ____

DEKLARUESI

(*Emri, atësia, mbiemri*)
(*Nënshkrimi*)